

platforma

**CiviKos**



# Buletini 10

**Korrik - Shtator 2016**

## Valdete Idrizi pranon Çmimin "TheWIFTS Peace Award 2016"

Valdete Idrizi, Drejtoreshë Ekzekutive e Platformës CiviKos, është fituese e Çmimit "TheWIFTS Peace Award 2016", për përkushtimin si aktiviste e madhe në ndërtim të paqes dhe komuniteteve në Kosovë.

Valdete Idrizi nuk ndalet së rreshturi për të punuar në ndërtim të paqes, dhe njihet edhe si motivim për shumë të rinj të Kosovës që marrin atë si model për të punuar në ndërtim të Paqes. Në pyetjen se si bëhet paqe znj. Idrizi tha: "Së pari, ju duhet bërë paqe me veten, për të zgjidhur të gjitha dilemat që mund të keni; të jesh një dëgjues i mirë, të kuptosh, të kesh vullnet të mirë dhe dashuri njerëzve dhe pastaj ju do të jeni në gjendje për të punuar me të tjerët, të vendosen urat e komunikimit, lidhjeve, dialogut dhe bashkëpunimit. Paqja është e gjitha çfarë duhet në lidhje me njerëzit, dhe të rinjtë janë grupi im të cilët janë një garanci për paqe të qëndrueshme. Në Kosovë, ne ende nuk kemi arritur që të kemi paqe të qëndrueshme, dhe ne do të arrijmë atë vetëm pasi të merremi me të kaluarën, të tregojmë shumëllojshmërinë dhe tolerancën ndërpersonale."

Idrizi ishte ndër themelueset dhe udhëheqëse e organizatës, Community Building Mitrovica (CBM) për një dekadë, e njohur jo vetëm në Kosovë për përkushtim në ndërtim të komuniteteve, ndërsa tash udhëheqë rrjetin më të madh të OSHC-ve në Kosovë, Platformën CiviKos. Ajo asnjëherë su ndal së përkrahuri nismat dhe fuqizimin e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë, dhe njihet si një nga aktivistet më të mëdhenj në ndërtim të paqës në Kosovë.

Përkushtimi i saj në ndërtim të Paqes është i njohur edhe në të kaluarën. Idrizi është fituese e Çmimit Ndërkombëtar për guxim "International Women of Courage Award" për Evropë, nga Departamenti i Shtetit të SHBA-ve në vitin 2008; Çmimi i Paqes Soroptimist në vitin 2009, dhe mori titullin ambasadore e Paqes nga Federata e Paqes Universale (UPF). Ajo ka marrë edhe shumë njohje nga organizatat rinore dhe të shoqërisë civile në përgjithësi



"Së pari, ju duhet bërë paqe me veten, për të zgjidhur të gjitha dilemat që mund të keni; të jesh një dëgjues i mirë, të kuptosh, të kesh vullnet të mirë dhe dashuri njerëzve dhe pastaj ju do të jeni në gjendje për të punuar me të tjerët, të vendosen urat e komunikimit, lidhjeve, dialogut dhe bashkëpunimit. Paqja është e gjitha çfarë duhet në lidhje me njerëzit, dhe të rinjtë janë grupi im të cilët janë një garanci për paqe të qëndrueshme. Në Kosovë, ne ende nuk kemi arritur që të kemi paqe të qëndrueshme, dhe ne do të arrijmë atë vetëm pasi të merremi me të kaluarën, të tregojmë shumëllojshmërinë dhe tolerancën ndërpersonale."

## Roli i shoqërisë civile – Rëndësia dhe ndikimi i saj në ndërtimin e shtetit

Drejtorja Ekzekutive e Platformës CiviKos, Valdete Idrizi, ka prezantuar punën e shoqërisë civile në Akademinë Verore Ndërkombëtare.

Ajo ka folur për rëndësinë dhe rolin e shoqërisë civile në ndërtimin e shtetit. Gjithashtu ka përmendur dhe promovuar punën e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë. Në ligjeratë ajo ka shpalosur punën në mobilizim të shoqërisë civile në dialog mes shoqërisë civile dhe qeverisë, si dhe rezultatet e deri tanishme të Këshillit për zbatim të Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile.

Duke folur edhe për rolin e CiviKos-it si rrjet ndër-sektorial në Kosovë, Valdeta gjithashtu iu foli edhe për përvojën e saj në ndërtimin e paqes. Pas prezentimit të Valdetes, pasuan pyetje nga më të ndryshmet që ndërlidhen me punën e OSHC-ve në

Kosovë, ndërtimit të paqes, rolit të CiviKos-it, dhe punës së saj si aktiviste.

Akademia Verore Ndërkombëtare është organizuar nga Qendra Kosovare për Diplomaci, ku morën pjesë rreth 60 pjesëmarrës nga 30 shtete të ndryshme të botës.



## Përzgjedhja e një anëtari të Shoqërisë Civile në Këshill

Këshilli për zbatimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile është një trupë e krijuar për të siguruar, koordinuar dhe monitoruar zbatimin e Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017 si dhe Planin e Veprimit për zbatimin e kësaj Strategjie 2013 -2015. Këshilli ka 29 anëtarë, 14 përfaqësues të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe 15 përfaqësues të shoqërisë civile. Nga përfaqësuesit e shoqërisë civile, 1 është emëruar nga Platforma CiviKos ndërsa 14 të tjerë janë zgjedhur nga vet organizatat e shoqërisë civile. Për shkak të largimit të një anëtari të shoqërisë civile, Civikos më 07.09.2016 kishte shpallur thirrje për përzgjedhjen e një anëtari të ri në Këshill.

Pas vlerësimit të nominimeve CiviKos shpalli të hapur procesin e votimit. Ky proces është organizuar dhe menaxhuar nga një komision i përbërë nga personeli i Sekretariatit të Platformës CiviKos, që caktohet nga Drejtori Ekzekutiv i CiviKos. Pas përfundimit të afatit për votim, Sekretariati i Platformës CiviKos, si bartëse e procesit për organizimin e zgjedhjeve për një anëtar të ri të shoqërisë civile në Këshill, me datë 27.09.2016 në zyrat e CiviKos, organizoi numërimin e votave për një përfaqësuesit të ri nga shoqëria civile në Këshill. Në mënyrë që procesi i numërimit të votave të jetë transparent, CiviKos ka ftuar në cilësinë e vëzhguesve përfaqësues të OSHC-ve, përfaqësues të mediejeve, asociacione dhe rrjete të ndryshme që veprojnë në Kosovë si dhe përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë, si dhe Zyra për Regjistrimin e OJQ-ve Kosovë. Ftesës për vëzhgues nuk i është përgjigjur askush. Pas verifikimit të votuesve u numëruan të gjitha votat ku gjithsej ishin 14 vota, nga to 12 të vlefshme dhe 2 të pa-vlefshme. Pas numërimit, Ares Shporta nga Fondacioni Lumbardhi u përzgjedhën anëtarë i ri në Këshill, me numrin më të madh të votave.



## Shoqëria Civile shënoi e ditën ndërkombëtare të Demokracisë

Me rastin e shënimit të ditës ndërkombëtare të demokracisë, Kuvendi i Kosovës me ndihmën e Sekretariatit të Platformës CiviKos organizoi panairin e shoqërisë civile me 15 Shtator 2016, para Kuvendit të Kosovës. Në panir morën pjesë një numër i organizatave ku ekspozuan materialet promovuese të tyre.

Panairi u vizitua nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës z. Kadri Veseli dhe deputetë tjerë ku patën mundësi të njoftohen nga afër me punën e Organizatave. Gjithashtu panairin e vizituan edhe shumë qytetarë tjerë që kishin ardhur për të vizituar Kuvendin.



Dita ndërkombëtare e Demokracisë

## Takimi i rregullt i Këshillit për zbatimin e strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile

Me datë 20 korrik 2016 u mbajt takimi i rregullt i Këshillit për Zbatimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013–2017, i cili u organizua nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit në bashkëpunim me Platformën CiviKos.

Në këtë takim me anëtarët e Këshillit që përfaqësohet nga shoqëria civile dhe institucione u bë prezantimi i të arriturave dhe sfidave në zbatimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile gjatë kësaj periudhe raportuese.

Pjesëmarrësit kryesisht u fokusuan në objektivat e strategjisë. Koordinatorët e ekipeve punuese të katër objektivave të strategjisë theksuan te arriturat, sfidat dhe hapat e mëtejshëm në proces të zbatimit të Planit të Veprimit. Pjesëmarrësit konkluduan që të vazhdohet të rritet koordinimi dhe bashkëpunimi i mirë me partner, institucione dhe shoqërinë civile.









Takimi i rregullt i Këshillit

## Aktivitetet tjera të Platformës CiviKos

- 17.07.2016 e Sekretariati i CiviKos ka organizuar një takim me anëtarët e Këshillit për zbatimin e Strategjisë Qeveritare në zyrat CiviKos. Qëllimi i takimit ishte për të diskutuar për ecurinë në zbatimin e Strategjisë dhe për të identifikuar problemet dhe sfidat para takimit të rregullt të Këshillit. Takimi u lehtësua nga Sekretariati i CiviKos. Progresi i Strategjisë është prezantuar përdorur Matricë e monitorimit të cilat Sekretariati i CiviKos përdorin për të monitoruar zbatimin e Strategjisë.
- 29.08.2016- Sekretariati i Platformës CiviKos, në bashkëpunim me ZQM ka organizuar takim me koordinatorët e katër grupeve të punës të Këshillit, për të koordinuar aktivitetet e ardhshme të Këshillit.
- 08.09.2016- Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) së bashku me Sekretariatit e Platformës CiviKos organizoi takimin e koordinatorëve të 4 grupeve punuese të Strategjisë. Gjatë takimit u prezantuan zhvillimet që janë në proces. Zhvillimet kryesore të cilat u prezantuan ishin, trajnimet për nëpunësit civilë në zbatimin e standardeve minimale për konsultime publike; Platforma E- platforma; analizë e legjislacionit për ofrimin e shërbimeve për OSHC-të, analizë e legjislacionit për vullnetarizëm.
- 09.09.2016 - Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) së bashku me Sekretariatit e Platformës CiviKos organizoi takim me grupin punues për Objektivën e parë. Në këtë takim u diskutua për E-Platforma. Sugjerimet nga grupi i punës do të përfshihen në versionin e fundit të E-Platforma.
- 23.09.2016- Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) së bashku me Sekretariatit e Platformës CiviKos ka organizuar takimin e grupit të punës për hartimin e Rregullores për Standardet Minimale mbi Financimin Publik. Më 30.09.2016 në Villa Germia është mbajtur mbledhja e parë e grupit të punës.
- Sekretariati i Platformës CiviKos ka marrë pjesë në rreth 100 ngjarje të ndryshme të organizuara nga orgnaizata anëtare dhe joanëtare, duke dhënë kontributin e saj qoftë përmes pjesëmarrjes në panel apo në cilësinë e diskutuesit. Gjithashtu ka mbajtur takime individuale me organizata anëtare duke ndihmuar dhe ofruar lehtësim në çështjet me interes. Poashtu ka takuar organizata të cilat kanë kërkuar të anëtarësohen, duke njoftuar me punën e CiviKos dhe lehtësuar procesin e aplikimit për anëtarësi.
- Sekretariati i Platformës CiviKos ka organizuar takime me koordinatorët e grupeve të Strategjisë punuar për të diskutuar zhvillimet e fundit në Strategjinë dhe përgatitjet e raportit mbi zbatimin e Strategjisë të cilat Sekretariati i Platformës CiviKos që do të publikohet gjatë muajit nëntor. Poashtu, në vazhdimësi lehtëson dhe koordinon punën e katër grupeve të punës duke lehtësuar komunikimin ndërmjet tyre dhe institucioneve.
- Sekretariati i CiviKos në mënyrë të vazhdueshme ka ndarë informata me organizatat anëtare, projektligjet për konsultime publike, draft dokumentet, mundësi për grante, mundësi për trajnime si dhe ngjarje të ndryshme me kërkesë nga organizatat anëtare. Gjithashtu, është në procesin e mbledhjes së të dhënave nga organizatat anëtare në lidhje me zbatimin e parimeve të Kodit të, raporti i cili do të publikohet në nëntor 2016.

## Platforma CiviKos në MEDIE

	<p>18 Korrik 2016</p> <p><b>Kryetarja Emini vlerëson punën e aktivistes Valdete Idrizi (Epoka e Re)</b></p>		<p>18 Korrik 2016</p> <p><b>Emini lavdëron punën e bërë nga Valdete Idrizi</b></p>
	<p>15 Korrik 2016</p> <p><b>Mysafiri i Mëngjesit-Zbatimi i Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë Civile, Dardan Kryeziu (RTK)</b></p>		<p>12 Korrik 2016</p> <p><b>Valdete Idrizi (KLAN Kosova)</b></p>
	<p>07 Korrik 2016</p> <p><b>Valdete Idrizi- Mysafire në BonBon (RTV21)</b></p>		<p>03 Korrik 2016</p> <p><b>Valdete Idrizi pranon çmimin për paqe (Zëri)</b></p>